



**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**KESHILLI KOMBETAR I UJIT**  
**KESHILLI I BASENIT UJEMBLEDHES "VJOSE", VLORE**

---

**VENDIM**

Nr. 6, Dt. 21.05.2010

*Per miratim te lejes se rinovuar, per shfrytezim inertesh ne shtratin e lumit Bistrice, ne nje mjedis teresisht lumor, ne afersi te fshatit Mesopotam (ne jug-perendim te tij), subjektit "Dinamika" sh.p.k, me administrator Z. Jani Papajani, komuna Mesopotam, Qarku Vlore.*

Ne zbatim te kerkesave qe percakton Ligji Nr.8093 Dt. 21/03/1996 "Per Rezervat Ujore", konkretisht, neni 8 dhe 20, vendimit nr. 1 dhe nr. 3, dt.21.06.2006, te K.K.U-se, si dhe vendimit nr.1 dhe nr.2 dt. 07.06.2007 te K.K.U-se, duke gjykuar mbi kerkesen dhe studimin e paraqitur nga subjekti "Dinamika" sh.p.k, me administrator Z. Jani Papajani, konform formularit "F", miratuar me vendimin nr.2, dt. 07.06.2007 te K.K.U-se, pasqyruar dhe ne relacionin shoqerues, paraqitur nga A.U.B "Vjose".

Keshilli i Basenit Ujembledhes "Vjose",

**VENDOSI:**

1- Te miratoj lejen e rinovuar, per shfrytezim inertesh ne shtratin e lumit Bistrice, ne afersi te fshatit Mesopotam (ne jug-perendim te tij), Komuna Mesopotam, subjektit "Dinamika" sh.p.k. Sarande.

2- Siperfaqja e dhene ne shfrytezim do te jete 0.019 km<sup>2</sup>/vit

E kufizuar nga piketat, me koordinata si me poshte.

X 1 = 44 19 716

Y 1 = 44 23 620

X 2 = 44 19 764

Y 2 = 44 23 670

X 3 = 44 19 548

Y 3 = 44 24 870

X 4 = 44 19 506

Y 4 = 44 24 876

3- Koha e shfrytezimit te zones do te jete ajo e percaktuar ne vendimin nr.1, dt. 21.06.2006 te K.K.U-se, nga dt.01.06.2010 deri me 31.10.2010, duke u ricikluar cdo vit, deri me dt. 21.05.2011, periudhe qe subjekti "Dinamika" sh.p.k, duhet te aplikoj per Lejen e re 5 vjecare.

• *Vazhdim i Vendimit Nr. 6, Dt. 21.05.2010.*

- 4- Volumi i materialit qe do te merret do te jete 20 000 m<sup>3</sup>/vit, brenda zones qe jepet ne shfrytezim, thellesia e shfrytezimit deri ne 2 m, por jo me shume se 0.5m mbi pasqyren e ujrave fratike.
- 5- Ngarkohet A.U.B “Vjose” per zbatimin e ketij vendimi.
- 6- Ky vendim hyne ne fuqi menjehere.

**PERGJEGJES I A.U.B “VJOSE”**  
**Ardian DINE**



**KRYETARI I K.B.U “VJOSE”**  
**Hasan HALILI**

